



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/2019

Datë: 21.05.2019

Procesverbal

i mbledhjes se IV (e katërt) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -III- të rregullt dhe mbledhjes së -I- urgjente të KPF-së.
2. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2019.
3. Shqyrtimi i Raportit të Detajuar i punës së Zyrës së Tatimit në Pronë për vitin 2018.
4. Shqyrtimi i Raportit të Detajuar i Punës së Drejtorisë për Urbanizëm për vitin 2018
5. Ndryshimi dhe plotësimi i Planit për Banim Social për vitin 2019-2021
6. Shqyrtimi i kërkesave.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë:03.05.2019, filloj në ora 10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, përfaqësuesi i Osbe, zyra për informim.

Rrahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e katërt a ka dikush diçka për rendin e ditës? Nëse nuk keni ndonjë propozim kush jeni për rendin e ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi e dy procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara?

Rrahim Morina: Kush jeni për miratim të këtyre dy procesverbaleve? Unanimisht ishin për.

2. Shqyrtimi i Raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Mars 2019.

Alban Krasniqi: Ketë pikë e trajtojmë edhe në Kuvend, shqetësim është vonesa e bartjes së mjeteve të vitit 2018, sepse tash e kemi bërë shpenzimin e tre muajve e ato mjete ishin shumë dikund 170 mijë euro qe ishte dashtë të barten. Është mire me dite sa mjete janë, planifikimin e tyre dhe me ar dhe me kohë.

Hashim Vrenezi: Edhe ne jemi me rekomanduar për Kuvend ketë raport e atë tepricë që duhet të barten në ketë vit është mirë me pas informata?

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi i Raportit të Detajuar i punës së Zyrës së Tatimit në Pronë për vitin 2018.

Rrahim Morina: Kush jeni që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i Raportit të Detajuar i Punës së Drejtorisë për Urbanizëm për vitin 2018

Rrahim Morina: Unë edhe me shkrim u kamë kërkuar të na sjellin raportin por nuk e kanë sjelle.

Alban Krasniqi: Për shkak të problematikave që përsëriten nga drejtoritë është caktu veçanërisht çështja se si kjo drejtori i ka kryer punët në vitin 2018, pra me një raport të detajuar një pasqyrë krahasuese dhe për problemet që i ka hasur. E pas këtyre mund te del ndonjë rekomandim që i shërben edhe drejtorisë se ka projekte sikur Inkubatori që ska as projekt e nga këto mungesa del kualiteti i punimeve i dobët. E aty ku nuk përgjigjet Kryetari dhe Drejtoritë ne mund t'i kemi masat tona.

Hashim Vrenezi: Për ketë raport ska arsyetim, sepse janë raportuar punët në teren e s'janë kryer fare. Ne duhet me dite ku kanë shkuar ato mjete por edhe nëse na sjellin në raport kanë mi devijuar. Ne duhet me ba presion sepse punët po kryhen e njerëzit as nuk dalin në teren e angazhojnë kompani pa

dal këta hiq në ngjarje, nuk dihet as ku fillon puna dhe as ku përfundon. Nisën kanalizime e shaktet e kanalizimeve mbesin mbi rrugë.

Rrahim Morina: Ne mund ta rekomandojmë vetëm nëse sillet materiali për ndryshe jo. Kush jeni me rekomandu nëse na sjellin material. Unanimisht ishin për.

5. Ndryshimi dhe plotësimi i Planit për Banim Social për vitin 2019-2021.

Alban Krasniqi: Po shoh një plan që e sjellin edhe për kuvend e kjo është i pa kapshëm në këtë formë. Marre me pa dikush këtë plan e ne tani jemi në vitin 2019, problemi është së ky është një plan i përditësuar, sepse në rastet kur Komuna ndërton shtëpi këtu në plan ishte dashtë mu hjek kjo, dhe duhet me ditë se ky plan më herët është miratuar.

Muharrem Morina: Ne ju kemi pas thënë se është ky plan i miratuar, ju keni pas kërkuar me fut në plan të punës me plotësuar këtë plan.

Alban Krasniqi: Ky është dashtë të jetë strategji me një kërkesë për me informua Kuvendin, por ky plan është dashtë të monitorohet.

Hashim Vrenezi: Pse ka ardh ky draft kur ky plan është i miratuar më herët.

Raimonda Krasniqi: Nëse është i miratuar jam mos me dergu hiq ne Kuvend.

Alban Krasniqi: Kërkesa ka qenë për informacione, sepse spo bëhet në formë programore.

Rrahim Morina: Kush jeni ta kthejmë të kryetari e që ndoshta është dashtë ta formojë edhe një komision rreth këtij plani. Kush jeni ta kthejmë për zyrën e kryetarit? Unanimisht ishin që ky plan të përcillet tek Kryetari i Komunës.

6. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa e parashtruar nga një grup i artistëve për hapje të një teatri.

Alban Krasniqi: Aktivitetet kulturore janë në nivel të ulët, aktivitetet mungojnë se janë kapur sikur qendra e rinisë. Aty është një zyrtar më kontratë ne vepër qe punon në Komunë dhe ai thotë jam edhe shef i qendrës rinore. Janë disa artist e ata deklarohen artist veç kur kërkojnë diçka si kjo kërkesë për teatër, sa shfaqje ata kanë bërë deri tash.

Raimonda Krasniqi: Në jetën e përditshme teatrin e kemi pjesë shpirtërore, e para me erdhi keq se kryetari me kaq shumë kërkesa thotë Malishevën e kemi bërë Paris, veç ideja si e kishin përpiluar këtë kërkesë ishte e tmerrshme, pastaj kërkohe punëtor shihet e politizuar dhe për mua është plotësisht e pa pranueshme.

Rrahim Morina: Unë mund t'i ftoj një takim sipas kërkesës tonë nga Kpf.

Kërkesa nr.02/192 datë:22.03.2019 e parashtruar nga Kryetari i fshatit Novosellë .

Rrahim Morina: Këta kanë bërë një kërkesë dhe kanë kërkuar shkëputje nga fshati Terpezë pra me kanë zonë kadastrale si fshat.

Muharrem Morina: Kjo si kërkesë duket e lehtë po ka një procedurë kogja të vështirë për me realizuar ata. Për mu nda ata si fshat duhet Kuvendi i Kosovës mi ndryshuar disa ligje si; Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji për kufijtë Administrativ e ligje tjera.

Rrahim Morina: Për mua kjo kërkesë është e drejtë, sepse ata para se me na sjellë këtë kërkesë ne e kishin parashtruar edhe në Ministri.

Alban Krasniqi: Për këso vendime duhet baza ligjore, dhe për këto çështje duhet nga banorët me kanë një Peticion dhe ne me pas fuqi me të madhe dhe mos të ngutemi se kjo çështje prekë pak edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Raimonda Krasniqi: Nëse nuk ka diçka të keqe a mundemi me rekomanduar për Kuvend.

Alban Krasniqi: Këtu duhet njëfarë referendumi i atyre qytetarëve, nëse ata e kanë problem për zgjedhje kur organizohen ata mundem me ba kërkesë dhe munden me ju ndihmu, kështu që në mbledhje të kuvendit me mirë ka qenë me pas peticion.

Rrahim Morina: Unë po i thërras ata ju tregoj që me ba një peticion e ne sot po e rekomandojmë për Kuvend. Kush jeni ta rekomandojmë këtë kërkesë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa e BIK për shpenzimet e varrimit.

Alban Krasniqi: Unë s'jam me futë në marrëveshje që shpenzimet të jenë të njëjta edhe për fëmijët dhe nëse futet kjo i bien që po behën pazare e që unë nuk jam ashtu me vepru.

Rrahim Morina: Në Kuvend jemi marrë vësh dhe a marr vendim që veç shuma nga 200 mu rrite në 230 asgjë tjetër. Ne kemi kërkuar që BIK të sjelle një specifikacion, ata tani na kanë sjelle dhe tash mos ta zhargitim se ka mbet veç kryetari me bashkësinë Islame me lidhe tash marrëveshje.

Hashim Vrenezi: Në marrëveshje të futet edhe ata persona që s'janë banore të Malishevës e që dëshirojnë të varrosen ne territorin e Malishevës. Mos t'i pengojmë pra edhe atyre te ju kryhen shërbimet e varrimit.

Muharrem Morina: Nëse doni me fute edhe ketë propozim ka qenë mire qe t'i rekomandohet kryetarit sepse kjo ska qenë debat kur e keni trajtu në Kuvend.

Alban Krasniqi: Harrone që prej hoxhallarëve keni vota, sepse ata as qytetarët si donë se kta bëjnë biznes. Kjo është shitje e vlerave njerëzore pra bëjnë pazare për vota. Edhe komisioni ka rekomanduar qe për fëmijët 50% me kanë më lire ju tash e ndryshoni se kur e keni mbajt takimin në zyrën e kryetarit ju keni thënë se është ne rregull.

Rrahim Morina: Ne BIK-ut u kemi kërkuar specifikacion ata e kanë sjellë se di çka ka mbete tjetër. Mundet mu fute edhe propozimi i Hashimit që të gjithë ata që s'janë banorë e që të dëshirojnë të varrosen ne Komunën e Malishevës tu kryhen shërbimet. Kush jeni që t'i rekomandohet kryetarit të Komunës të lidhe marrëveshjen për shpenzimet e varrimit? Unanimisht për ishin 4.

Kërkesa e Islam Balaj firma Graniti.

Kërkesa i përcillet Kryetarit të Komunës? Unanimisht ishin për.

Kërkesa e Afrim Morinës nga fshati Drenoc

Kërkesa i përcillet Komisionit për familjet e pa strehë? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/209 datë:03.04.2019 e parashtruar nga z.Daut Berisha nga fshati Carravranë, Komuna e Malishevës, për ndihmë financiare për shërim te gruas së tij.

Raimonda Krasniqi: Ka qenë një rast më herët e kemi ndihmuar financiarisht por mjetet financiare si kanë dalë.

Rrahim Morina: Mua me kanë thënë në drejtori të financave se kanë me zbatu ketë vendim.

Hashim Vrenezi: Kur ka këso raste të kemi informacion se këto raste a janë ndihmuar ndonjëherë nga Komuna apo dikush tjetër.

Rrahim Morina: Kush jeni që Daut Berishës t'i ndihmohet me 500 euro, për shërimin e gruas së tij? Unanimisht për ishin 4 anëtarët e KPF-së.

Rrahim Morina: Kemi 5 kërkesa për ndërrim destinim të tokës;

Kërkesa nr.06/29 datë:15.03.2019 të parashtruar nga z.Mujedin Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/27 datë:18.03.2019 të parashtruar nga z.Hazir Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/28 datë:18.03.2019 të parashtruar nga z.Alban Tredhaku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/33 datë:21.03.2019 të parashtruar nga z.Qamil Vesel Hoti nga fshati Carrallukë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/38 datë:27.03.2019 të parashtruar nga z.Bahti Thaçi nga fshati Mirushë, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Rrahim Morina: Kush jeni që këto kërkesa të rekomandohen për Kuvend? Unanimisht ishin 4 për.

7. Të ndryshme.

Rrahim Morina: Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi ne ora 11:50 min.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip

